



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORE

Nr. 2346 Prot.

Vlorë, më 05/08/2026

Lënda : Kërkesë për shpallje publike të aktit administrativ (Vendimi i Kontabilizimit)

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Departamentit Ekonomik dhe Burimeve Mbështetëse

Drejtorisë së Aseteve dhe Burimeve Mbështetëse

Sektorit të Zgjidhjeve dhe Suportit Help Desk

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj shpalljen publike të një akti administrativ – Vendimi i kontabilizimit i detyrimeve doganore si vijon :

- Nr.75, me Nr.1285/2 Prot., datë 19/05/2026, i materializuar për subjektin “BESTCONF” sh.p.k, me NUIS M33622402F, me seli në Fier (NB Afrim, Zona kadastrale nr. 3984, nr pasurie 288, vol. 2, faqe 38; Telefon: 0694667321).

Jemi në pritje të konfirmimit nga ana Juaj për datën e shpalljes publike. Bashkëngjitur, gjeni kopje të aktit të lartcitur - gjithsej 4 (katër) fletë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.1285/2 Prot.

Vlorë, më 19/05/2026

VENDIM Nr.75

Sot, më datë 19/05/2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit “BESTCONF” sh.p.k, me NUIS M33622402F, me seli në Fier (NB Afrim, Zona kadastrale nr. 3984, nr pasurie 288, vol. 2, faqe 38; Telefon: 0694667321), si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces Verbalit të konstatimit me nr.1285 Prot., datë 04/05/2026, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

KONSTATOVA SE:

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa me Nr.16652/16 Prot., datë 12/03/2026, protokolluar me Tonën me nr.2514/10, datë 13/03/2026, me lëndë “*Dërgimi i Raportit Përfundimtar të Auditimit*”. Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, nga Dega e Doganës Vlorë u hartua “Plani i Punës” me nr.2514/11 Prot., datë 30/03/2026, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga ana e Grupit të Punës është kryer rishqyrtimi i rekomandimit të lënë ndaj këtij subjekti.

Në kontrollin dhe verifikimin e tre deklaratave doganore IM.4 – (R 2130; 4097; 4708 / 2024), me të cilën nga ana e subjektit “BESTCONF” sh.p.k, me NUIS M33622402F, i përfaqësuar nga Agjencia Doganore “Gad Universi” me kod J 102, është deklaruar artikulli (malli) “Material për mbushje jastëku”, klasifikuar në kodin tarifor *5503*.

Rezulton se organi konstatues ka rekomanduar si vijon : “*Sistemi i vlerësimit doganor u vlerësua duke përpunuar raportet nga sistemi Oracle, si dhe Asycuda World. Gjatë periudhës së audituar, vlerësimi i artikujve është bërë kryesisht duke pranuar transaksionin si vlerë doganore. Nga auditimi rezultoi se efekti ekonomik i ndërhyrjeve në vlerën e deklaruar në (%) dhe në vlerë absolute është relativisht i ulët. Vlerësimi është bërë duke marrë parasysh ndërhyrjet për këto produkte nga DVQ në deklaratat e tjera doganore për arsye se, nuk plotesonin kushtet bazë për t’u kaluar në transaksion. Subjektet mundësojnë faturë, por kanë mungesë dokumentacioni shtesë si: kontratë mes palëve për fiksimin e çmimit,*

proformë paraprake e blerjes së produktit të rivlerësuar dhe swift bankar pagese. Nuk plotësoheshin kushtet e vendosura në nenin 66 të ligjit 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar. Gjendur në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për aplikimin e vlerës së transaksionit, u procedua me rivlerësim me metoda alternative, sipas radhës së përshkruar në Nenin 67 të Kodit Doganor.

Në disa raste dokumentacioni shoqëruar nuk ka : 1- Kontratë me firmën shitëse; 2- Dokumentacion bankar që vërteton transferimin faktik të shumave monetare në lidhje me transaksionin e kryer është dukshëm më i ulët në raport me të dhënat e disponueshme dhe të artikujve në databaze. 3- Dokument justifikues për kushtet e lëvrimit të mallit.

Komente: 1- Vlera doganore e mallit, nuk mund të përcaktohet në bazë të Nenit 66 të KD, duke u bazuar vetëm në çmimin e blerjes pa dokumentacion shtesë në mbështetje të transaksionit dhe në përputhje me dispozitat zbatuese Kodit Doganor dhe akteve nënligjore për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore. 2- Subjekti ekonomik, nuk ka paraqitur informacion dhe dokumentacion shtesë të nevojshëm për përcaktimin e vlerës doganore në mungesë të së cilës refuzohet transaksioni. Për këto arsye grupi i auditimit mori në shqyrtim zhdoganimin e mallrave dhe rivlerësoi për qëllime doganore disa nga artikujt e importuar nga subjektet ekonomike si më poshtë :

Lidhur me importet dhe deklaratimet e artikullit "fibra sintetike", deklaruar në kodin tarifor 55032000 të NKM-së, me origjinë nga BE-ja, përfaqësuar nga Agjencia Doganore "Gad Universi" J102, rezultoi se nga sektori i vlerës praktikave doganore të mëposhtme janë trajtuar me transaksion, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.3 të Kodit Doganor.

Ky artikull, "fibra sintetike", nga i njëjti eksportues dhe me të njëjtën origjinë, në sistemin doganor, në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nuk plotëson kushtet e pranimin të transaksionit, është vlerësuar sipas metodës 6 të vlerësimit me 0.6 euro/kg EU (Ref. DAV-i 3128, datë 03.07.2024).

Për këtë arsye, subjektin "Bestconf" sh.p.k., me NIPT M33622402F, i linden detyrimet doganore të papaguara, në zbatim të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si më poshtë: "...".

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tregtar bashkëngjitur tre praktikave doganore në sistemin Asycuda World, konstatohet se këto deklarata doganore nuk përmbushin kushtet për vlerësim sipas metodës së transaksionit. Në zbatim të legjislacionit doganor nga ana e grupit të kontrollit pranë Degës së Doganës Vlorë, është proceduar me marrjen në shqyrtim të rekomandimit për deklaratat doganore të lartcituara, në përfundim të të cilit, kanë konkluduar se rekomandimi është i drejtë dhe për këtë fakt kanë mbajtur

shkresën Nr.1285 Prot., datë 04.05.2026 me lëndë “Proces Verbal”, ku midis të tjerave kanë arsyetuar si vijon : “...Pas marrjes në shqyrtim të deklaratave doganore të vitit 2024, me të cilën nga ana e subjektit “BESTCONF” sh.p.k, me NUIS M33622402F, përfaqësuar nga Agjencia Doganore “Gad.Universi” me kod J 102, është deklaruar artikulli (malli) “material për mbushje jastëku”, i klasifikuar në kodin tarifor *5503*. Në zbatim të nenit 70 të Kodit Doganor, si dhe bazuar në historikun e këtij artikulli, i njëjti artikull zhdoganohet me çmimin 0.6 euro/kg.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tregtar, bashkëngjitur praktikës doganore në sistemin Asycuda World, konstatohet se kjo deklaratë doganore nuk përmbush kushtet për vlerësim sipas metodës së transaksionit...”.

Në këto kushte, Grupi i Punës vlerëson se referuar nenit 70 pika 3 të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, autoriteti doganor nuk është i detyruar të pranojë vlerën e deklaruar të transaksionit në rastet kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme mbi saktësinë ose plotësinë e informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga deklaruesi. Në rastin konkret, mungesa e dokumentacionit mbështetës mbi marrëdhënien kontraktore ndërmjet palëve, mungesa e dokumentacionit bankar që provon pagesën reale të transaksionit, si dhe mungesa e dokumentacionit mbi kushtet e lëvrimit të mallit, nuk lejojnë verifikimin objektiv të çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar për mallrat e importuara.

Në kushtet kur metoda e vlerës së transaksionit nuk mund të aplikohet, organi doganor ka vijuar me zbatimin e metodave alternative të vlerësimit doganor sipas rendit hierarkik të përcaktuar në nenin 67 të Kodit Doganor, duke u mbështetur në të dhënat objektive dhe të disponueshme në administratën doganore, përfshirë historikun e importeve të artikujve të ngjashëm ose identikë, të trajtuar më parë nga Dega e Doganës Vlorë.

Subjekti ekonomik, edhe pse kishte barrën për të provuar vërtetësinë dhe saktësinë e vlerës së deklaruar, nuk ka administruar prova të mjaftueshme dokumentare për të rrëzuar dyshimet e arsyeshme të autoritetit doganor mbi vlerën e deklaruar.

Në këto rrethana, duke qenë se nuk plotësohen kushtet për pranimin e metodës së vlerës së transaksionit sipas nenit 66 të Kodit Doganor, organi doganor ka proceduar drejt me kalimin në metodat alternative të vlerësimit, sipas rendit të përcaktuar në nenin 67 të po këtij Kodi.

Për sa më sipër, rekomandimi i lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm është i bazuar në ligj dhe në provat e administruara në praktikën doganore, Për rrjedhojë, detyrimet doganore shtesë të përcaktuara për deklaratat doganore objekt shqyrtimi rezultojnë të ligjshme dhe të bazuara në dispozitat

e legjislacionit doganor në fuqi. Rezulton se rivlerësimi doganor dhe detyrimet doganore shtesë janë përcaktuar në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë dhe akteve nënligjore në fuqi, mbi bazën e të dhënave objektive, të verifikueshme dhe të administruara ligjërisht nga autoriteti doganor.

Për sa më lart, mbështetur në kreun III “Vlera për qëllime doganore” neni 65 e vijues të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimin 03, datë 23.01.2018 “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” të Ministrit të Financave,

V E N D O S A :

- Subjekti “BESTCONF” sh.p.k, me NUIS M33622402F, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **17,000** (Shtatëmbëdhjetëmijë) lekë.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Zyra e Mbikqyrjes Doganore të procedojë me rregullimin e situatës sipas pikës 1 të Vendimit.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “BESTCONF” sh.p.k, me NUIS M33622402F, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

